



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 8

Tiranë – E hënë, 18 janar 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 153/2020, datë 17.12.2020	Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur..... 1503
Dekret i Presidentit nr. 11914, datë 12.1.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 1514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 13.1.2021	Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2021..... 1514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 13.1.2021	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal, për periudhën 2022–2024..... 1517
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 13.1.2021	Për një ndryshim në vendimin nr. 1087, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2021”..... 1529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 13.1.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Linja 110 kV me dy qarqe n/stacioni Bushat – n/stacioni Velipojë”..... 1529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 13.1.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 246, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të kalimit për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i korridorit të kalimit të gazsjellësit TAP (pjesë e projektit TAP)”..... 1532
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 13.1.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikimi urban i bllokut që kufizohet nga bulevardi ‘Bajram Curri’, bulevardi ‘Petro Nini Luarasi’, rruga ‘Taulantia’, rruga ‘Ali Demi’, Tiranë’..... 1569



LIGJ
Nr. 153/2020

PËR REGJIMIN FISKAL NË SEKTORIN
HIDROKARBUR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj parashikon regjimin fiskal të zbatueshëm për operacionet hidrokarbure, siç rregullohen në legjislacionin në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi).

Neni 2
Personat e tatueshëm

1. Ky ligj zbatohet për personat juridikë që kryejnë operacione hidrokarbure në tokë (*onshore*). Për personat juridikë që kryejnë operacione *offshore* në det, sistemi fiskal i zbatueshëm përcaktohet me ligj të veçantë.

2. Ky ligj zbatohet për personat që kryejnë operacione hidrokarbure të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi).

3. Për të parandaluar shmangien e regjimit fiskal në sektorin hidrokarbur, ky ligj ka efekt dhe zbatohet edhe për personat juridikë të përcaktuar në këtë nen dhe që kryejnë direkt ose indirekt operacione hidrokarbure (të referuar si “nënkontraktorë”), që plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme:

a) nëse nënkontraktori që kryen operacione hidrokarbure konsiderohet “person i lidhur” me kontraktorin sipas përkufizimit të “personit të lidhur” në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat;

b) nëse nënkontraktori është operator në lidhje me operacionet hidrokarbure dhe kryen aktivitete të cilat janë thelbësore për operacionet hidrokarbure. Për qëllim të këtij ligji, aktivitete thelbësore për operacionet hidrokarbure konsiderohen nëse niveli i kontributit të faturimeve të nënkontraktorit në totalin e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure të personit të autorizuar është jo më i vogël se 25%;

c) nëse qëllimi kryesor i marrëveshjes me nënkontraktorin është shmangia nga nënkontraktori i normës së tatimit sipas këtij ligji dhe përfitimi i normës tatimore sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

4. Këshilli i Ministrave miraton, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, rregullat e detajuara për zbatimin e këtij neni.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Në fushën e zbatimit të këtij ligji janë rregullimi i:

a) detyrimit për taksën mbi rentën minerare, tatimin mbi fitimin për operacionet hidrokarbure, si dhe administrimin e tyre;

b) masës në të cilën një marrëveshje hidrokarbure mund të ndikojë në detyrimin për vendosjen e taksave e të tatimeve, si dhe taksat/tatimet vendore dhe kombëtare të aplikueshme.

Neni 4
Përkufizimet

1. Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Autoritet rregullator” është ministria përgjegjëse për aktivitetin hidrokarbur, ose çdo institucion tjetër i autorizuar nga ministria, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi);

b) “E drejtë hidrokarbure” është e drejta e një personi për të kryer operacione hidrokarbure, duke përfshirë të drejtën e një personi sipas një marrëveshjeje hidrokarbure dhe të drejtën e nënkontraktorit për të cilën zbatohet ky ligj sipas nenit 2, për të kryer operacione hidrokarbure në emër të një personi tjetër;



c) “Fond i miratuar i rehabilitimit”, në lidhje me një operacion të veçantë hidrokarbur, nënkupton një fond:

i. të kërkuar me ligj ose me të drejtën hidrokarbure dhe të miratuar për këtë qëllim nga ministri përgjegjës për çështjet hidrokarbure;

ii. të krijuar për të plotësuar shpenzimet që do të lindin për braktisjen, rehabilitimin dhe eliminimin e operacionit; dhe

iii. ku kontributet për fondin janë vendosur jashtë kontrollit të personit që kryen operacionin ose palës së lidhur;

ç) “Hidrokarbure”, “Marrëveshje hidrokarbure”, “Naftë bruto”, “Rentë minerare” dhe “Operacionet hidrokarbure” kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi);

d) “Klauzolë e stabilitetit të regjimit fiskal”, në marrëveshjen hidrokarbure është klauzola që garanton se regjimi fiskal, i cili zbatohet për personin e autorizuar për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, do të vazhdojë të zbatohet ose që nuk do të ndryshohet në dëm të personit;

dh) “Marrëveshje për financimin e shpenzimeve (*farm out*)”, në lidhje me të drejtën hidrokarbure, përfshin një marrëveshje për transferimin e një pjese të së drejtës në këmbim të pagesës që përfshin, në tërësi ose pjesërisht, një detyrim nga ana e marrësit, për të paguar një shumë shpenzimesh të ardhshme për operacionet hidrokarbure, shpenzime të cilat janë joproporcionale me pjesën takuese të marrësit të së drejtës në periudhën kur kryhen shpenzimet;

e) “Nënkontraktor” ka kuptimin e dhënë në nenin 2 të këtij ligji;

ë) “Operacion i veçantë hidrokarbur” ka kuptimin e dhënë në nenin 8 të këtij ligji;

f) “Operacion hidrokarbur i autorizuar” nënkupton operacionet hidrokarbure të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi);

g) “Pagesë e lidhur me rezultatin” është pagesa periodike, në masën që ajo llogaritet, duke iu referuar fitimit, prodhimit ose hidrokarbureve të nxjerra nga operacionet e lidhura ose jo me naftën apo gazin, qofshin këto të kryera ose jo nga personi që kryen këtë pagesë;

gj) “Pika e lëvrimit” është pika e parashikuar në marrëveshjen përkatëse hidrokarbure ose, në

mungesë të një dispozite të tillë, pika e përcaktuar nga ministri përgjegjës për çështjet hidrokarbure;

h) “Plan zhvillimi” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi);

i) “Rregullat e transferimit të çmimit” dhe “krahueshmërisë së transaksionit” aplikohen në përputhje me përcaktimet për këtë qëllim në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, të zbatuara pa kufizime ndërkufitare dhe pavarësisht nëse transaksioni kryhet tërësisht brenda Shqipërisë ose nga palët rezidente ose jorezidente

j) “Tatim, taksë” janë tatimet dhe taksat e vendosura në Republikën e Shqipërisë dhe përfshijnë taksat doganore, akcizat, tatimin mbi të ardhurat, rentën, tatimin mbi vlerën e shtuar, taksat kombëtare, vendore;

k) “Zonë e kontratës” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi);

l) “Zonë zhvillimi dhe prodhimi” është zona e identifikuar në një plan zhvillimi të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet hidrokarbure, sipas legjislacionit në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi).

2. Termat e tjerë të papërkufizuar shprehimisht në këtë ligj, kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar respektivisht në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat dhe për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi).

KREU II RENTA MINERARE

Neni 5 Vendosja e rentës minerare

1. Mbajtësi i një të drejte hidrokarbure duhet të paguajë rentë minerare për hidrokarburet e nxjerra në bazë të së drejtës.

2. Renta minerare llogaritet duke aplikuar një normë prej dhjetë përqindësh të vlerës së tregut të hidrokarbureve (naftë dhe gaz) të nxjerra në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji.

3. Sasia e hidrokarbureve të nxjerra matet në pikën e lëvrimit.

4. Renta minerare nuk aplikohet për:

a) mostrat e hidrokarbureve të marra për analizë, shqyrtim, ekzaminime ose teste të tjera,



por renta minerare paguhet nëse një mostër shitet; dhe

b) hidrokarburin, që në përputhje me marrëveshjen hidrokarbure, është:

i. djegur ose çliruar në lidhje me operacionet hidrokarbure; ose

ii. përdoret drejtpërdrejt në të njëjtin operacion të veçantë hidrokarbur nga i cili nxirret.

5. Renta paguhet në momentin dhe sipas procedurës së përcaktuar në kreun V të këtij ligji.

Neni 6

Vlera e tregut e hidrokarbureve të nxjerra

1. Për qëllime të llogaritjes së rentës minerare, vlera e tregut e hidrokarbureve të nxjerra është:

a) çmimi me të cilin nafta apo gazi shitet në pikën e lëvrimit; ose

b) në transaksione ndërmjet palëve të lidhura, nëse çmimi i përcaktuar sipas shkronjës “a” të kësaj pike është më i ulët se çmimi që do të caktohej ndërmjet palëve të pavarura për një shitje në pikën e lëvrimit, çmimi në pikën e lëvrimit, përcaktohet duke zbatuar rregullat e transferimit të çmimit.

2. Pavarësisht parashikimit të pikës 1 të këtij neni, kur hidrokarburet furnizohen sipas një kontrate më të gjatë se një vit, administrata tatimore mund të lidhë një marrëveshje çmimi në avancë, sipas nenit 36/7, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

KREU III

TATIMI MBI FITIMIN PËR OPERACIONET HIDROKARBURE

Neni 7

Aplikimi i tatimit mbi fitimin

1. Një person që kryen operacione hidrokarbure i nënshtrohet tatimit mbi fitimin të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

2. Fitimet e tatueshme të një personi nga operacionet hidrokarbure llogariten dhe tatohen sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Fitimet e tatueshme të një personi nga operacionet johidrokarbure llogariten dhe tatohen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

4. Të ardhurat dhe shpenzimet që krijohen, rrjedhin dhe/ose shkaktohen nga kryerja e aktivitetit ndahen ndërmjet operacioneve hidrokarbure dhe atyre johidrokarbure, në mënyrë të tillë që të mos ketë mbivendosje.

5. Tatimi mbi fitimin nga operacionet hidrokarbure për një periudhë tatimore llogaritet duke aplikuar shkallën tatimore 50% të fitimit të tatueshëm nga operacionet hidrokarbure për këtë periudhë.

6. Fitimet e tatueshme nga operacionet hidrokarbure për një periudhë tatimore llogariten si shumë totale e fitimeve të tatueshme nga secili prej operacioneve të veçanta hidrokarbure për këtë periudhë, duke përfshirë humbjet.

7. Për qëllime të llogaritjes së fitimeve të tatueshme nga operacionet hidrokarbure:

a) çdo operacion i veçantë hidrokarbur trajtohet si një biznes i pavarur dhe personi duhet t'i mbajë të dhënat financiare për këtë biznes të ndara nga çdo aktivitet tjetër ekonomik i tij;

b) personi duhet të llogarisë fitimin e tatueshëm, humbjen dhe detyrimin e tatimit mbi fitimin për biznesin në mënyrë të pavarur për çdo periudhë tatimore.

8. Për të kufizuar shmangien e tatimit, transferimi i një aktivi në ose nga një operacion i veçantë hidrokarbur trajtohet si blerje dhe shitje e aktivitetit.

9. Kur dy ose më shumë persona janë bashkërisht mbajtës të një të drejte hidrokarbure, ata duhet të llogarisin secili më vete fitimet e tyre të tatueshme nga operacionet hidrokarbure që lidhen me këtë të drejtë, por duke vepruar me transaksionet ndërmjet tyre në kushtet e trajtimit si “palë të lidhura”.

10. Rregullat e transferimit të çmimit aplikohen për transaksionet e mëposhtme sikur të jenë transaksione të kontrolluara ndërmjet palëve të lidhura:

a) ndërveprimet midis një operacioni të veçantë hidrokarbur dhe veprimtarive të tjera të personit që kryen operacionin hidrokarbur (duke përfshirë operacionet e tjera të veçanta hidrokarbure ose operacionet johidrokarbure, të tilla si rafinimi ose procese të tjera); dhe

b) marrëdhëniet ndërmjet dy ose më shumë personave, që janë mbajtës të së drejtës hidrokarbure.



Neni 8

Operacionet e veçanta hidrokarbure

1. Operacionet hidrokarbure, që i përkasin çdo të drejte hidrokarbure, përbëjnë një operacion të veçantë hidrokarbur.

2. Kur zona e zhvillimit dhe prodhimit është miratuar brenda zonës së kontratës, atëherë:

a) operacionet hidrokarbure të kryera në zonën e kontratës deri në datën e miratimit dhe operacionet hidrokarbure të kryera në zonën e zhvillimit pas kësaj date trajtohen si të kryera në lidhje me të njëjtin operacion të veçantë hidrokarbur; dhe

b) nga data e miratimit, operacionet hidrokarbure të kryera në zonën e kontratës, por jashtë zonës së zhvillimit dhe prodhimit trajtohen si një operacion i ri i veçantë hidrokarbur.

3. Pika 4 e këtij neni zbatohet kur:

a) një zonë zhvillimi dhe prodhimi është miratuar brenda një zone të kontratës; dhe

b) më pas mbajtësi i së drejtës hidrokarbure heq dorë nga e gjithë zona e kontratës, që nuk është zonë zhvillimi dhe prodhimi.

4. Operacionet hidrokarbure:

a) që i atribuohen zonës nga e cila është hequr dorë, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni;

b) që kryhen nga data e miratimit të zonës së zhvillimit dhe prodhimit, sipas shkronjës “a” të pikës 3, deri në datën e heqjes dorë, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, i atribuohen zonës së zhvillimit dhe prodhimit, të përmendur në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni. Kjo do të thotë se operacionet hidrokarbure trajtohen si të kryera në lidhje me operacionin e veçantë hidrokarbur që kryhet në zonën e zhvillimit, të përmendur në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni.

5. Nëse më shumë se një zonë zhvillimi dhe prodhimi është miratuar brenda një zone të kontratës, referencat për “zonën e zhvillimit” në pikat 3 e 4 të këtij neni janë vetëm për zonën e fundit të zhvillimit të miratuar.

6. Ministri përgjegjës për financat, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për çështjet hidrokarbure, miraton udhëzime për:

a) dispozita të mëtijshme për përcaktimin e operacioneve të veçanta hidrokarbure; dhe

b) dispozita për trajtimin e të drejtave të ngjashme hidrokarbure dhe bashkimin e të drejtave hidrokarbure.

Neni 9

Fitimet e tatueshme dhe humbjet e lejuara

1. Fitimi i tatueshëm i një personi nga një operacion i veçantë hidrokarbur për një periudhë tatimore llogaritet duke zbritur nga të ardhurat e kësaj periudhe nga ky operacion shumat e mëposhtme:

a) shpenzimet e zbritshme të këtij operacioni për këtë periudhë; dhe

b) humbjet e lejuara nga operacioni, të mbartura nga periudhat e mëparshme.

Shumat, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, lejohet të zbriten me kushtin që zbritja të mos kalojë 85% të të ardhurave nga ky operacion për këtë periudhë.

2. Në aplikimin e kufizimit për zbritjen sipas pikës 1 të këtij neni, shumat sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni kanë përparësi në zvogëlimin e fitimit të tatueshëm ndaj shumave sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.

3. Një humbje e lejuar nga një operacion i veçantë hidrokarbur për një periudhë tatimore të caktuar është masa në të cilën shpenzimet e zbritshme të operacionit për periudhën tejkalojnë 85% të të ardhurave nga ky operacion për këtë periudhë.

4. Humbjet e lejuara mund të mbarten për një periudhë të pacaktuar derisa të përdoren për të zvogëluar fitimet e tatueshme, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.

5. Një humbje e lejuar bëhet e palejuar deri në masën që përdoret për të zvogëluar fitimet e tatueshme.

6. Humbjet e lejuara nga një operacion i veçantë hidrokarbur nuk mund të zvogëlojnë fitimet e tatueshme nga ndonjë operacion tjetër hidrokarbur apo fitimet e tatueshme nga operacione johidrokarbure.

7. Humbjet nga operacione johidrokarbure nuk mund të zvogëlojnë fitimet e tatueshme nga operacionet hidrokarbure.



Neni 10 Të ardhurat

1. Të ardhurat e një personi nga një operacion i veçantë hidrokarbur për një periudhë tatimore janë totali i shumave bruto të mëposhtme:

a) vlera e tregut e hidrokarbureve të shitura gjatë periudhës nga operacioni, siç referohet në nenin 5 të këtij ligji, dhe e vlerësuar sipas nenit 6 të këtij ligji;

b) shumat bruto të përfituara gjatë periudhës nga transferimi ose përdorimi i aktiveve të tjera të operacionit, pavarësisht nëse këto janë aktive qarkulluese ose aktive fikse;

c) shumat e përfituara gjatë periudhës nga kompensimet dhe të ardhurat nga sigurimet në lidhje me operacionin;

ç) tepricat në një fond rehabilitimi të çdo shume të parashikuar në nenin 16 të këtij ligji;

d) çdo e ardhur tjetër e personit nga operacionet e veçanta hidrokarbur, duke përfshirë shumat e përfituara gjatë periudhës nga ofrimi i shërbimeve ose informacionit gjatë kryerjes së operacionit.

2. Përfshihen nga të ardhurat e një operacioni të veçantë hidrokarbur:

a) interesi dhe fitimet e tjera financiare, përfshirë shumën që trajtohet si e ardhur nga interesi; dhe

b) pagesa për transferimin e së drejtës hidrokarbur.

Neni 11 Shpenzimet e zbritshme

1. Shpenzimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, janë shpenzime të zbritshme të një operacioni të veçantë hidrokarbur për një periudhë tatimore, me kusht që:

a) shpenzimi është kryer nga personi gjatë periudhës dhe është i lidhur drejtpërdrejt me kryerjen e operacionit;

b) shpenzimi i kryer është në përputhje me marrëveshjen hidrokarbur, si dhe standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në industrinë e hidrokarbureve, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi); dhe

c) zbritja nuk është kufizuar nga neni 12 i këtij ligji.

2. Shpenzimet e zbritshme janë:

a) pagesat për buxhetin, përfshirë tarifatat, taksat, tatimet dhe rentën minerare, sipas nenit 5 të këtij ligji;

b) shpenzimet e lidhura me marrëdhëniet e punësimit, përfshirë koston e përfitimeve në natyrë të punonjësve, kontributet e sigurimeve të pagueshme nga punëdhënësi, koston për rialokimin e punonjësve, trajtimin mjekësor, sigurimin e jetës, si dhe dietat brenda kufijve të përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat;

c) shpenzimet për blerjen e materialeve, të pajisjeve dhe të furnizimeve;

ç) koston e transportit të punonjësve, të pajisjeve, të materialeve dhe të furnizimeve;

d) koston e shërbimeve dhe të shërbimeve publike të nevojshme të ofruara nga palët e treta, përfshirë koston e analizave, përpunimin e të dhënave, planifikimin, studimin, mbikëqyrjen dhe këshillimin në lidhje me gjeologjinë, inxhinierinë, kiminë, ndikimin në mjedis, kontabilitetin, auditimin, fushën ligjore, burimet njerëzore, financimin, kontraktimin dhe prokurimin;

dh) shpenzimet e tjera administrative, por jo më shumë se 2.5% të kostove të tjera për periudhën tatimore në të cilën janë kryer shpenzimet e tjera administrative;

e) koston për sigurimin, zëvendësimin, riparimin ose magazinimin e materialeve, të pajisjeve dhe të furnizimeve;

ë) shumat e depozituara dhe shpenzimet e tjera që janë kryer në lidhje me një fond rehabilitimi të miratuar të operacionit të veçantë hidrokarbur;

f) koston e braktisjes, të rehabilitimit dhe të eliminimit të operacionit të veçantë hidrokarbur, por vetëm në masën që ndonjë fond rehabilitimi i miratuar është i pamjaftueshëm për mbulimin e kostove; dhe

g) shpenzime të tjera të nevojshme për kryerjen e operacionit të veçantë hidrokarbur, që përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

3. Një shpenzim mund të kualifikohet si shpenzim i zbritshëm pavarësisht nëse është shpenzim operativ apo shpenzim kapital.

Neni 12 Shpenzimet e pazbritshme

Shpenzime të pazbritshme janë:



a) amortizimi;

b) interesi, kostot financiare dhe kostot e shkaktuara në lidhje me instrumentet financiare, përfshirë shumat zëvendësuese për interesin ose të trajtuara si kosto financimi nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;

c) pagesat që lidhen me rezultatin, sipas kuptimit të dhënë në nenin 4 të këtij ligji;

ç) kostot për marrjen, mbajtjen, përmirësimin, mbrojtjen ose transferimin e së drejtës hidrokarbure, përfshirë çdo pagesë bonusi të kryer në lidhje me të drejtën;

d) pagesat që bën për të siguruar pjesëmarrje në fitimet, faturimet ose shpenzimet e operacioneve hidrokarbure ose johidrokarbure;

dh) shumat që tejkalojnë kufirin e parashikuar në pikën 5 të nenit 13 të këtij ligji;

e) tatimi mbi fitimin; dhe

ë) shpenzimet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, por:

i. duke përjashtuar shpenzimet, sipas shkronjës “b” të nenit të sipërpërmendur; dhe

ii. duke mos lejuar zbritjen për të gjitha shpenzimet e përcaktuara në shkronjën “h” të nenit të sipërpërmendur.

Neni 13

Shpërndarjet, alokimet dhe kontabiliteti

1. Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj, shumat e përfshira ose të zbritura në llogaritjen e fitimeve të tatueshme të një operacioni të veçantë hidrokarbur duhet:

a) të llogariten në bazë të të drejtave të konstatuara, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar; dhe

b) të përfshijnë rregullime dhe ndryshime për të mbuluar pasaktësitë.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për të ardhurat nga hidrokarburet e nxjerra.

3. Shumat që duhet të përfshihen ose të zbriten në llogaritjen e fitimeve të tatueshme dhe aktivet e përdorura në nxjerrjen e fitimeve të tatueshme duhet të alokohen/atribuohen aty ku ato i përkasin në rastet kur ka:

a) më shumë se një operacion të veçantë hidrokarbur; ose

b) operacione të lidhura ose jo të lidhura me hidrokarburet.

4. Për të shmangur dyshimin dhe në bazë të neneve 14 e 15 të këtij ligji, shumat që i atribuohen siç duhet operacioneve hidrokarbure, që janë përjashtuar nga të ardhurat sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji, ose që nuk janë të zbritshme sipas nenit 12 të këtij ligji, nuk merren në konsideratë në llogaritjen e fitimeve të tatueshme nga operacionet johidrokarbure.

5. Rregullat e transferimit të çmimit zbatohen për shumat e përfshira ose të zbritura në llogaritjen e fitimeve të tatueshme të një operacioni të veçantë hidrokarbur dhe çdo alokimi sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Kur personi që kryen një operacion të veçantë hidrokarbur paguan një palë të lidhur për aktivet, shërbimet ose mjete të tjera të dhëna për operacionin, çdo zbritje e pretenduar nga personi kufizohet në “shumën pa fitim”.

7. Për qëllim të pikës 6 të këtij neni, “shuma pa fitim” përfshin kostot reale të shkaktuara nga pala e lidhur në sigurimin e aseteve, të shërbimeve ose të pajisjeve, por duke përjashtuar çdo kosto të shkaktuar nga pala e lidhur në favor të një personi tjetër që lidhet me palën e lidhur.

Neni 14

Marrja dhe mbajtja e të drejtave hidrokarbure

1. Marrja, mbajtja dhe heqja dorë nga një e drejtë hidrokarbure nuk është pjesë e operacioneve hidrokarbure. Në përputhje me pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji, kjo e drejtë konsiderohet si pjesë e operacioneve johidrokarbure të mbajtjesit dhe për të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

2. Për qëllim të pikës 1 të këtij neni, një e drejtë hidrokarbure trajtohet si:

a) pasuria e paluajtshme, që është e ndarë nga çdo interes tjetër në tokë që përbën zonën e kontratës dhe çdo aktiv tjetër që përdoret në operacionet hidrokarbure; dhe

b) një aktiv i amortizueshëm, që duhet të amortizohet në normën 5%, në përputhje me pikën 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

3. Rregullat e mëposhtme zbatohen për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të tatueshme nga operacionet johidrokarbure, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat:



a) shpenzimet e përcaktuara në shkronjën “b” të nenit 12 të këtij ligji, nuk janë të zbritshme në masën që i atribuohen një të drejte hidrokarbure; dhe

b) kostoja e një të drejte hidrokarbure mund të përfshijë shpenzimet e referuara në shkronjën “d” të nenit 12 të këtij ligji, por nuk përfshin shpenzimet e referuara në shkronjën “b” të nenit 12 të këtij ligji.

4. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton metodën e alokimit/atribuimit të shpenzimeve të referuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, për të drejtën hidrokarbure, duke përfshirë dhe u bazuar në një vlerë krahasuese të aktiveve ose qarkullimit/xhiros.

Neni 15

Transferimi i të drejtave hidrokarbure

1. Transferimi i një të drejte hidrokarbure, në tërësi ose pjesërisht, shkakton pasoja tatimore për operacionet hidrokarbure dhe johidrokarbure të personit që kryen shitjen.

2. Në lidhje me operacionet hidrokarbure zbatohen rregullat e mëposhtme, por vetëm kur e drejta hidrokarbure transferohet së bashku me të njëjtën pjesë proporcionale të interesit të transferuesit në operacionin e veçantë hidrokarbur të kryer sipas të drejtës. Për qëllime të llogaritjes së tatimit, të pagueshëm nga marrësi, transferohen te marrësi:

a) humbjet për operacionin hidrokarbur (nëse ka) të mbartura në periudhën tatimore në të cilën ndodh transferimi dhe që janë humbje të lejuara në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;

b) të ardhurat për operacionin hidrokarbur lidhur me naftën dhe gazin e nxjerrë ose ndryshe të përfutur gjatë periudhës tatimore dhe në kohën e transferimit që përfshihen në përcaktimin e nenit 10 të këtij ligji;

c) shpenzimet për operacionin hidrokarbur, të shkaktuara gjatë periudhës tatimore dhe deri në kohën e transferimit, të cilat janë të zbritshme sipas nenit 11 të këtij ligji; dhe

ç) këstet tatimore të paguara gjatë periudhës tatimore dhe kohës së transferimit, siç kërkohet nga neni 23 i këtij ligji.

Këto shuma alokohen sipas shkallës së interesit të transferuar. Në masën që humbjet, të ardhurat,

shpenzimet dhe këstet janë transferuar, ato nuk i atribuohen më transferuesit.

3. Në lidhje me operacionet johidrokarbure, pika 7, e nenit 22, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, zbatohet për transferimin, tërësisht ose pjesërisht, të një të drejte hidrokarbure.

4. Kur një e drejtë hidrokarbure transferohet, tërësisht ose pjesërisht, së bashku me aktivet e tjera, qoftë të përdorura në operacione hidrokarbure apo johidrokarbure, neni 13 i këtij ligji zbatohet për shpërndarjen proporcionale të shpenzimeve, të kostove dhe të shumave të shkaktuara nga transferimi.

5. Në përcaktimin e shumës së vlerësuar të transferimit të një të drejte hidrokarbure, duke përfshirë transferimin sipas një marrëveshjeje për financimin e shpenzimeve (*farm-out*), ose kur vlerësimi për transferimin përfshin edhe ndonjë pagesë që lidhet me rezultatin në të ardhmen:

a) përfshihen shumat ose përfitimet që do të merren në të ardhmen nga transferimi; dhe

b) kur këto shuma ose përfitime do të merren në më shumë se një vit në të ardhmen, shumat llogariten me vlerën e tyre aktuale të tregut duke përdorur metodologjinë e vlerës aktuale neto të pagesave të ardhshme; dhe

çdo shumë ekuivalente që trajtohet nga marrësi i së drejtës hidrokarbure, si pjesë e kostove të tij.

6. Për qëllime të përcaktimit të fitimeve të tatueshme nga operacionet johidrokarbure, nenet 27 dhe 27/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, zbatohen për transferimin indirekt të një të drejte hidrokarbure.

Neni 16

Fondet e miratuara të rehabilitimit

1. Një fond rehabilitimi i miratuar përjashtohet nga tatimi.

2. Një tepricë në një fond rehabilitimi të miratuar të një operacioni të veçantë hidrokarbur të kryer nga një person përfshihet në të ardhurat nga operacioni kur:

a) ministri përgjegjës për çështjet hidrokarbure vërteton se braktisja, rehabilitimi dhe eliminimi i operacionit është i plotë dhe personi ka të drejtë të marrë tepricën; ose



b) personi shkel kushtet e braktisjes, të rehabilitimit dhe të eliminimit të miratuar nga ministri.

3. Shumat e paguara nga një fond i miratuar rehabilitimi i një operacioni të veçantë hidrokarbur te personi që kryen operacionin për të përmbushur shpenzimet e braktisjes, të rehabilitimit dhe të eliminimit të operacionit nuk janë të ardhura të personit.

KREU IV

MARRËVESHJET HIDROKARBURE

Neni 17

Detyrimi për marrjen në konsideratë të marrëveshjeve hidrokarbure

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë nen ose në ndonjë dispozitë të legjislacionit fiskal, përfshirë edhe këtë ligj, marrëveshja hidrokarbure ose ndryshimi i saj nuk ka ndikim në zbatimin e një ligji fiskal, përfshirë edhe këtë ligj. Kjo nënkupton që administrata tatimore duhet të zbatojë dhe të administrojë kuadrin ligjor fiskal, pa marrë parasysh marrëveshjet hidrokarbure.

2. Në përputhje me nenin 20 të këtij ligji, rregullat e pikave 3 e 4 të këtij neni zbatohen vetëm:

a) kur marrëveshja hidrokarbure, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave ka hyrë në fuqi dhe ministri përgjegjës për financat ia përcjell për zbatim administratës tatimore; dhe

b) vetëm për personat që kanë të drejtë të kryejnë operacione hidrokarbure, sipas marrëveshjes dhe jo për ndonjë person tjetër.

3. Në rastin e një marrëveshjeje hidrokarbure ose ndryshimi të saj, të lidhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore zbaton legjislacionin fiskal pasi merr në konsideratë çdo mbrojtje specifike ose përjashtim fiskal të parashikuar në marrëveshje.

4. Në rastin e një marrëveshjeje hidrokarbure ose ndryshimit të saj, të lidhur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore duhet të zbatojë legjislacionin fiskal pas marrjes në konsideratë të:

a) ndonjë klauzole të miratuar të stabilitetit të regjimit fiskal në marrëveshje, siç parashikohet nga neni 18 i këtij ligji; dhe

b) lehtësimit nga taksat/tarifat vendore të parashikuara në marrëveshje, siç përcaktohet në nenin 19 të këtij ligji.

Neni 18

Klauzola e miratuar e stabilitetit fiskal

1. Një klauzolë e stabilitetit të regjimit fiskal në një marrëveshje hidrokarbure (ose ndryshim të saj) të lidhur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbron një mbajtës të së drejtës hidrokarbure nga:

a) vendosja e tatimeve dhe e taksave të reja diskriminuese, tarifave e detyrimeve të tjera financiare, të vendosura nga qeveria, që nuk ekzistojnë në datën kur është lidhur marrëveshja;

b) ndryshimi i tatimit ose taksës ekzistuese, tarifës ose detyrimeve të tjera financiare të vendosura nga qeveria në mënyrë diskriminuese; ose

c) ndryshimi në dëmin material të mbajtësit të së drejtës nga:

i. renta minerare, norma e tatimit mbi fitimin dhe tatimit në burim, si dhe tarifatat për importin e mallrave ose shërbimeve; ose

ii. ndryshimet në strukturën e bazës së taksës, në metodologjinë e llogaritjes së saj, mbi të cilën vendosen detyrimet e referuara në nënndarjen “i” të kësaj pike, duke përfshirë rregullat për zbritjen e shpenzimeve dhe humbjeve.

2. Një klauzolë e stabilitetit të regjimit fiskal ose ndryshim në të, që përfshin mbrojtjen sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, pushon së qeni një klauzolë e miratuar e stabilitetit të regjimit fiskal 12 (dymbëdhjetë) vjet nga data e fillimit të prodhimit sipas marrëveshjes hidrokarbure. Përjashtohen nga regjimi i stabilitetit ligjet dhe rregulloret që lidhen me sigurinë kombëtare, marrëdhëniet e punës, mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut, traktatet ndërkombëtare, në të cilat është anëtare Republika e Shqipërisë.

Ky rregull nuk zbatohet nëse klauzola është shtyrë nga marrëveshje të mëvonshme.



Neni 19

Lehtësimi nga taksat vendore dhe taksat e tjera

Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të zbatojnë lehtësim nga taksat/tarifat vendore të parashikuara nga marrëveshja hidrokarbure.

Neni 20

Shmangia e përfitimeve të dyfishta nga marrëveshjet hidrokarbure

1. Një palë në një marrëveshje hidrokarbure nuk mund të pretendojë njëkohësisht:

a) një mbrojtje specifike apo përjashtim/lehtësim sipas marrëveshjes në lidhje me legjislacionin fiskal; dhe

b) në të njëjtën kohë, përfitime nga ndryshimet lehtësuese në legjislacionin fiskal që ndodhin pas miratimit të marrëveshjes hidrokarbure.

2. Kur në përputhje me nenin 17 të këtij ligji, një marrëveshje hidrokarbure parashikon mbrojtje specifike apo përjashtim/lehtësim nga detyrimet tatimore, mbrojtja specifike apo përjashtimi/lehtësimi nga detyrimet tatimore do të vazhdojnë të zbatohen deri në datën më të hershme të:

a) përfundimit të marrëveshjes ose klauzolës përkatëse, që parashikon mbrojtje specifike apo përjashtim/lehtësim nga detyrimet tatimore në marrëveshje; ose

b) heqjes dorë nga personi mbi të drejtën për trajtim të ndryshuar dhe të mbrojtur.

KREU V ADMINISTRIMI

Neni 21

Raportimi dhe pagimi i detyrimeve tatimore në monedhën vendase

Personat që kryejnë operacione hidrokarbure duhet të mbajnë regjistrimet, të raportojnë dhe të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në monedhën vendase, siç parashikohet me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore.

Neni 22

Deklarata tatimore dhe pagesa e rentës minerare

1. Renta minerare për hidrokarburet e nxjerra gjatë një muaji kalendarik duhet të paguhet nga mbajtësi i të drejtës hidrokarbure brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit të ardhshëm kalendarik.

2. Në çdo rast kur paguhet renta minerare, mbajtësi i së drejtës hidrokarbure duhet të paraqesë pranë administratës tatimore deklaratën tatimore të rentës minerare.

3. Deklarata tatimore e rentës minerare duhet t'i dorëzohet administratës tatimore në mënyrën dhe formën e përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat. Deklarata tatimore duhet të përcaktojë:

a) sasinë e hidrokarburit mbi të cilin llogaritet renta minerare;

b) vlerën e tregut të hidrokarburit të llogaritur sipas nenit 6 të këtij ligji;

c) vlerën e rentës minerare që duhet të paguajë personi; dhe

ç) çdo informacion tjetër që kërkohet nga udhëzimi i ministrit.

Neni 23

Deklarata tatimore dhe pagimi i tatimit mbi fitimin për operacionet hidrokarbure

1. Një person që kryen operacione hidrokarbure duhet të paraqesë më vete një deklaratë tatimore për operacionet hidrokarbure të kryera nga ai dhe një deklaratë tjetër tatimore për operacionet johidrokarbure. Deklarata tatimore për operacionet hidrokarbure duhet të raportojë fitimet e tatueshme veçmas për çdo operacion të veçantë hidrokarbur. Neni 29 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, zbatohet për deklaratat tatimore për operacionet hidrokarbure dhe ato johidrokarbure.

2. Sistemi i kësteve, i parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, zbatohet për pagesën e tatimit mbi fitimin për sa u përket operacioneve hidrokarbure dhe johidrokarbure.

3. Ministri përgjegjës për financat nxjerr udhëzim për zbatimin e këtij neni.



Neni 24

Marrëdhënia me ligjin për procedurat tatimore

1. Procedura e parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore zbatohet për administrimin e këtij ligji.

2. Përveç parashikimit në pikën 1 të këtij neni, nenet 31 dhe 32 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, zbatohen për shkeljet administrative dhe dënimet në lidhje me këtë ligj.

Neni 25

Koordinimi me autoritetin rregullator

1. Në administrimin e këtij ligji, administrata tatimore duhet të punojë në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin rregullator. Për këtë qëllim, administrata tatimore dhe autoriteti rregullator ndajnë informacione të tilla që lidhen në mënyrë të parashikueshme me funksionet e tyre përkatëse dhe mund të kryejnë kontrole të përbashkëta. Kjo nuk lehtëson ose kufizon administratën tatimore në detyrën e saj për mbledhjen e informacionit dhe kontrollin e operacioneve hidrokarbure për qëllime të legjislacionit fiskal.

2. Administrata tatimore duhet të marrë në konsideratë përcaktimet e autoritetit rregullator:

a) nëse një person kryen operacione hidrokarbure;

b) për sasitë e hidrokarbureve të nxjerra nga personi që kryen operacione hidrokarbure;

c) për alokimin e të ardhurave në operacionet hidrokarbure, duke përcaktuar nëse të ardhurat i përkasin një operacioni të veçantë hidrokarbur ose një operacioni tjetër;

ç) për alokimin e shpenzimeve në operacionet hidrokarbure, duke përcaktuar nëse shpenzimet i përkasin një operacioni të veçantë hidrokarbur ose një operacioni tjetër; dhe

d) nëse një person shkel kushtet e braktisjes, të rehabilitimit dhe të eliminimit, të miratuara nga ministri përgjegjës për çështjet hidrokarbure.

3. Administrata tatimore dhe autoriteti rregullator duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të përbashkët, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore.

4. Ky nen zbatohet krahas nenit 86 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 26

Parashikimet financiare

1. Një mbajtës i të drejtës hidrokarbure duhet që:

a) në secilin nga rastet e referuara në pikën 2 të këtij neni dhe për çdo vit të kohëzgjatjes së parashikuar të së drejtës hidrokarbure (duke përfshirë çdo mundësi për zgjatje), duhet të përgatisë parashikimet për:

i. shumat, burimet, metodat, afatet dhe kushtet e financimit të operacioneve hidrokarbure sipas të drejtës;

ii. kostot e kërkimit, zhvillimit dhe operimit, si dhe kostot kapitale shtesë që do të lindin pas fillimit të prodhimit tregtar;

iii. sasitë e prodhimit dhe kushtet e pritshme të shitjes, veçanërisht në lidhje me çmimin;

iv. marrëveshjet e prodhimit ose të ndarjes së fitimit, duke përfshirë shpërndarjet e pritshme, politikat në të cilat do të bazohen shpërndarjet dhe rendin e përparësisë ndërmjet shpërndarjeve dhe pagesave të tjera (veçanërisht interesi dhe shlyerja e borxhit);

v. tatimet, taksat dhe të ardhurat e tjera që duhet t'i paguhen shtetit shqiptar dhe mënyrën e llogaritjes së këtyre shumave; dhe

vi. çdo informacion tjetër që mund të parashikojë ministri përgjegjës për financat;

b) të përdorë një model të përshtatshëm të përcaktuar nga ministri përgjegjës për financat, në kryerjen e parashikimeve të referuara në shkronjën “a” të kësaj pike; dhe

c) të caktojë një punonjës, në mënyrë të përhershme, i cili të njoftojë me shkrim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare së Burimeve Natyrore:

i. me vjetërsi të mjaftueshme pune për të pasur mundësi për akses në informacionin e përmendur në shkronjën “a”; dhe

ii. i cili do të kontaktojë me DPT-në dhe AKBN-në për çështjet e parashikuara nga ky nen.

2. Parashikimet sipas shkronjës “a” të pikës 1 duhet të përgatiten dy herë në vit, duke përcaktuar parashikimet sipas datave dhe duhet të dërgohen te



DPT-ja dhe AKBN-ja sipas afateve të përcaktuara me udhëzimin e ministrit.

3. Pas marrjes së parashikimeve sipas pikës 2, të këtij neni, DPT-ja dhe AKBN-ja, me njoftim me shkrim, mund të kërkojnë nga mbajtësi i së drejtës të japë të dhëna të mëtejshme dhe më të hollësishme të parashikimeve. Mbajtësi i së drejtës duhet t'i depozitojë këto të dhëna brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit.

4. Nëse një mbajtës i së drejtës hidrokarbure vihet në dijeni të fakteve që bëjnë materialisht të pasakta parashikimet më të fundit të përmendura në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, atëherë mbajtësi i së drejtës duhet të njoftojë menjëherë DPT-në dhe AKBN-në dhe të japë informacion të përditësuar.

5. Një mbajtës i së drejtës, i cili nuk jep informacionin në lidhje me parashikimet, detajet ose përditësimet e mëtejshme, siç kërkohen nga ky nen, dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo shkelje.

6. Informacioni i marrë sipas këtij neni mund të dërgohet në ministrinë përgjegjëse për financat për qëllime të parashikimit të të ardhurave buxhetore dhe për qëllime të administrimit financiar publik. Në çdo rast tjetër informacioni u nënshtrohet kërkesave të nenit 25 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me çdo përshtatje të nevojshme.

7. Për zbatimin e këtij neni, ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për hidrokarburet nxjerrin udhëzim të përbashkët.

KREU VI NDRYSHIMET DHE DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 27

Trajtimi si dividend i pagesës së lidhur me rezultatin

Një pagesë e lidhur me rezultatin, e cila është shpenzim i pazbritshëm sipas nenit 12 të këtij ligji, trajtohet si dividend për qëllimet e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

Neni 28

Dispozita kalimtare

1. Për qëllime të nenit 9 të këtij ligji, humbjet e lejuara të një operacioni të veçantë hidrokarbur përfshijnë kostot e parikuperuara të operacionit, të shkaktuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni:

a) “kostot e parikuperuara” merr kuptimin nga marrëveshja përkatëse e hidrokarbureve; dhe

b) kostot e parikuperuara të shkaktuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të lejuara si humbje vetëm nëse janë të kontrolluara e të vërtetuara si të sakta dhe i atribuohen operacionit hidrokarbur nga autoriteti rregullator.

Neni 29

Shfuqizimi i legjislacionit ekzistues

1. Ligji nr. 7811, datë 12.4.1994, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)” shfuqizohet.

2. Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në fund të pikës 4 të nenit 4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Taksa e rentës minerare për hidrokarburet e nxjerra përcaktohet me ligjin “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.”;

b) grupi i shtatë në shtojcën nr. 2 shfuqizohet.

Neni 30

Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të pikës 4 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për hidrokarburet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të neneve 8, pika 5, dhe 26, pika 7 të këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për financat brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr udhëzim për zbatimin e tij.



Neni 31
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.12.2020.

DEKRET
Nr. 11914, datë 12.1.2021

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Daniela Rusland Xhindoli
2. Vojsava Sami Sfyris (Kola)
3. Aurel Zeni Qinami
4. Elida Kristaq Margariti (Shandro)
5. Anton Ukshin Nika
6. Olimpion Jani Vodo
7. Esmiralda Muharrem Kurti (Tafaj)
8. Espera Samel Kurti
9. Elda Llambi Laux (Dylgjeri)
10. Aferdita Spiro Iannone (Berdufi)
11. Kristian Edmond Dilo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 6, datë 13.1.2021

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË
AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2021, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 e nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe